



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr 02 /630

Datë : 11.11.2020

Bazuar në kompetencat dhe përgjegjësit e parapara me nenin 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nenit 9 të Rregullores së MF-se nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizata Buxhetore, rekomandimit të Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë Jo Financiare të Komunës së Shtimes dhe Statutit të Komunës së Shtimes, kryetari i Komunës, mori këtë:

VENDIM

Aprovohet vendimi për tjetërsimin e pasurisë jo financiare të Komunitetit në komunën e Shtimes .

Arsyetim

Më 29.10.2020, Zyra e Kryetarit ka formuar Komisionin për Vlerësimin e Pasurisë Jo Financiare për vitin 2020, për të gjitha njësitë buxhetore. Komisioni ka bërë vlerësimin e pasurisë jo financiare në Shtëpinë e Komunitetit në Shtime, për të cilin vlerësim më 30.10.2020 ka përgatitur raport me shkrim, të cilit i ka bashkangjitur procesverbalin.

Po ashtu edhe siç e parasheh Rregullorja e MF-se nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizata Buxhetore, komisioni ka përgatitur edhe rekomandimin me të cilin rekomandon që të bëhet asgjësimi i pasurisë jo financiare, sipas gjendjes së paraqitur në procesverbal.

Në bazë të punës së kryer nga komisioni dhe në bazë të rekomandimit të këtij komisioni, se pasuria është e pa përdorshme dhe jashtë funksionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi menjëherë.



Kryetari i Komunës
Naim Ismajli